



# IRDK info

Nr.09/13  
Fletushkë informative mujore  
Shtator, 2013



## KRYESIA E IRDK-së DISKUTON PËR ZGJEDHJET E 3 NËNTORIT



Portë e Identitetit dhe  
Dinjitetit tonë Kombëtarë



"Antropologjia Socio-  
Kulturore e Egjiptianëve  
në Ballkan" promovohet  
edhe në Tiranë



Elemente reflektimi mbi  
Ballkano-Egjiptianët



## Votëbesimi dhe njerëzit me mjekrra e pa musteqe

**N**e Egjiptianët e Kosovës, pa i përjashtuar edhe ashkalitë në Rrafshin e Kosovës, në periudhat e fushatave parazgjedhore, jemi njerëzit të cilët na ofrohen më se shumti alternativa për të zgjedhur në ditën e votimit. Kjo nuk ndodh për shkak se vëllazëritë dhe motrat tona e kanë problem të zgjedhin më të mirin, por për shkak se vëllazëritë dhe motrat tona, të gjitha partive ia bëjnë me sy. Më se keqti ndahen përfaqësuesit e partive të cilat drejtohen nga bashkombasit e tyre.

Në periudha të zgjedhjeve, njerëzit në përgjithësi bien në siklet, për shkak se votën e tyre e lakmojnë jo vetëm një parti. Më se keqti gjenden votuesit tanë, të cilët pa asnjë nevojë, i shkaktojnë vetvetes telashe duke iu premtuar votën e tyre partive që drejtohen nga komuniteti shumicë. Nëse në një komunë të Kosovës dihet se ekzistojnë 900 - deri 1000 votues Egjiptian, dhe rezultati arrin mezi në 300 vota, atëherë kjo është më shumë se zhgënjyese dhe aspak shpresëdhënëse për progres të komunitetit. Një gjë është e sigurt se kjo nuk ndodh vetëm për shkak se përfaqësuesit e tyre nuk janë treguar të mirë atëherë kur e kanë marrë besimin, por kjo ndodh për shkak se përfaqësuesit e tyre nuk ia mbushin mendjen motrave dhe vëllazërve.

Dihet shumë mirë se nëse në një komunë zgjidhet një këshilltarë në Kuvendin Komunal, ai ose ajo nuk e ka në dorë vendimmarrjen, por rëndësia e përfaqësimit në këto organe qëndron për këto arsye:

- Përcjellja nga afër e zhvillimeve dhe mundësia e ndërhyrjes në rastet që kanë të bëjnë me interesat e komunitetit. Në këtë rast, imuniteti i këshilltarit komunal mundëson adresimin dhe kanalizimin e zgjidhjes së problemeve të komunitetit, si dhe pjesëmarrjen në mekanizma që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe promovimin e interesave të komuniteteve.

- Përfaqësim i besueshëm i interesave të komunitetit - është shumë e sigurt se asnjë këshilltar komunal nga etnitë tjera i cili zgjidhet me votat e komunitetit tonë, nuk do të përfaqësoj interesat e komunitetit, bile përgjithmonë do të mbaj sekret se me cilat vota është zgjedhur.

- Përfaqësimi moral i komunitetit - potencialin që e zotëron komuniteti, që në këtë rast është e drejta për të votuar, e ka adresuar në institucionet lokale dhe ka treguar afinitet për të jetuar të dinjitetshëm sikurse njerëzit e etnive tjera.

Arsyet e mia që i përmenda mund të tingëllojnë si demagogji, ose sipërfaqësore, por ajo që jam shumë i sigurt është fakti se votuesit e komunitetit egjiptian, nuk duhet të nënçmojnë vetveten. Votuesit e komunitetit egjiptian të Kosovës nuk duhet të votojnë në terr. Ata nuk duhet të

nënçmohen nga vetvetja, për të dhënë besimin e përfaqësimit atyre që edhe hapur i shprehim ndjenjat raciste ndaj komunitetit tonë.

Votuesit e komunitetit egjiptian kanë mundësi të gjejnë arsye për pakënaqësi me përfaqësuesit e tyre, dhe pastaj të mos votohen, por kjo nuk është rruga e drejtë. Votuesit e komunitetit egjiptian duhet të dinë se ka pasur progres në avancimin e pozitës së tyre. Ata nuk duhet të harrojnë se me këmbëngulje të përfaqësuesve të tyre janë krijuar lehtësira për regjistrim të nxënësve dhe studenteve, janë ndërtuar shtëpi të ndihmave për shumë skamnorë, kanë rrymë e ujë për shkak se është insistuar nga përfaqësuesit e tyre, bile në kohën e fundit janë asfaltuar edhe disa rrugë në lagjet e banuara etnikisht, natyrisht me insistimin e përfaqësuesve të tyre.

Aktualisht, te pjesëtarët e komunitetit egjiptian por edhe ashkali, e në veçanti në diasporë, është bërë dukuri e shprehur me të madhe predikimi i fesë muslimane, e kjo më se shumti duke i rritë mjekrrat e duke u kujdesur për me i rru musteqet. Nuk ka dyshim se predikimi i fesë është shumë pozitive, e që është instrument shumë i fortë që na largon nga të këqijat e mundshme. Por nuk është aspak e mirë që këta njerëz të mos mërzhiten hiq se cila ka qenë e kaluara e tyre dhe kush jemi ne, cilës etni i takojmë, a jemi të trajtuar drejt nga pushteti e mileti, etj. Ndoshta këta edhe kanë të drejtë, por këtë nuk e bëjnë prej largpamësisë së tyre, por për shkak se dëshirojnë me ngjallë tabun për identitetin tonë etnik, ose nuk dojnë të jenë pjesë e grupeve "që po bëjnë ndasi" pasi që ne flasim shqip dhe tjetër gjuhë nuk kemi. Edhe pse e dinë, e injorojnë faktin se ne jetojmë në shoqëritë ku etnia është mbi të gjitha, dhe ngarkesat etnike janë të shprehura me nacionalizëm. Nuk e di se si ndihen këta njerëz me mjekrra e pa musteqe kur kokëulur mundohen me e fsheh identitetin etnik ose me mashtruar vetveten me një identitet që realisht nuk i takon. Është për keqardhje se një pjesë e madhe e kësaj kategorie njerëzish, mblidhen shpesh e bëjnë namaz bashkë, i kanë mësuar edhe shkronjat arabe dhe kuranin e lexojnë edhe arabisht, kanë përparuar në fjalorin e "muslimanizuar", i komentojnë ajetet e kuranit edhe i ndërlidhin me realitetin, i gjejnë shenjat e kiametit në realitetin që jetojmë, por kurrqysh nuk e shohin vetveten dhe popullin e vet në pozitë aspak të mirë. Këtyre që ia ka qu zoti dijen me lexu, dhe kanë fitu dije nga leximi, a mos kishte qenë mirë me ba ka një grimë dert, në oda ose xhamia, edhe për gjendjen e popullit që i takojnë, apo me ba lutje për krejt dynjanë, e veç për vetveten jo.

*fstollaj@gmail.com*



## Kryesia e IRDK-së diskuton për zgjedhjet

Me datën 03 Gusht 2013, në Pejë është mbajtur Mbledhja e Kryesisë së IRDK-së ku është diskutuar lidhur me Zgjedhjet Lokale që priten të mbahen me datën 03 Nëntor të këtij viti. Kryetari i IRDK-së Xhevdet Neziraj, i cili e ka udhëhequr mbledhjen, ka potencuar nevojën e dominimit të një klime të përshtatshme dhe të qetë, duke i lenë anash rivalitetet në këto zgjedhje në mënyrë që kjo të reflektohet në dobi të rezultateve të zgjedhjeve. Gjatë debatit janë potencuar tri çështje kryesore që kanë të bëjnë me zgjedhjet - Çështja e bartësve të listave nëpër komuna, çështja e krijimit të shtabit zgjedhor dhe financimi i fushatës zgjedhore. Çështja e bartësve të listave është debatuar gjatë për shkak se me ligjin aktual për zgjedhjet lokale bartësi i listës nuk votohet por shkon drejtpërdrejt nëse janë fituar vota të mjaftueshme për subjektin politik. Pjesa dërmuese e anëtareve të Kryesisë së IRDK-së e kanë mbështetur propozimin që Kryesia të merr qëndrim që bartës të listave nëpër

komuna ku garon IRDK të jenë kryetarët e degëve. Këtë propozim e ka kundërshtuar anëtari i Kryesisë së IRDK-së Imer Alijaj i cili ka vlerësuar se ky qëndrim i Kryesisë është antiligjor dhe ka këmbëngulur që lista komplete të përpilohet nga Kryesitë e degëve, pasi që siç ka thënë ai ky qëndrim po i krijon favor kryetareve të degëve në mënyrë jo të drejt. Pas një debati të gjatë Kryesia e IRDK-së ka marrë vendim që listave nëpër të gjitha degët e IRDK-së të iu prijnë kryetarët e degëve. Kryetar i Shtabit Zgjedhor dhe person kontaktues në KQZ është zgjedhur sekretari i përgjithshëm Veton Berisha, ndërsa Përgjegjësi Financiar Elbert Krasniqi për mbledhjen e ardhshme do të hartoj planin për financimin e fushatës zgjedhore. Në Mbledhje të Kryesisë ka marrë pjesë edhe Ramiz Zizaku i cili është autorizuar më parë që të organizoj Kuvendin Zgjedhor për degën e IRDK-së në Gjermani.



## Beslim Hoti rikthehet në Kryesinë e IRDK-së

**M**e datën 20.07.2013, në Gjakovë është mbajtur mbledhja e Kryesisë së IRDK-së. Në këtë mbledhje, pas një periudhe të gjatë, ka marrë pjesë edhe Beslim Hoti i cili ka vendosur që kontributin e tij me bashkëpunëtorët e tij të jap në IRDK të cilën e kishte themeluar dhe udhëhequr për disa mandate. Në këtë mbledhje është mirëpritur kthimi i Beslim Hotit dhe Bashkëpunëtorëve të tij në IRDK dhe në këtë rast Kryesia e IRDK-së miratoi një Deklaratë në të cilën mirëpritet kthimi i Beslim Hotit në IRDK dhe pritet formalizimi i pozitës së tij në Kryesi dhe i degës së IRDK-së në Gjakovë e cila pritet të udhëhiqet nga Beslim Hoti. Në këtë mbledhje u vlerësua gjithashtu se unifikimi i subjekteve politike që i përfaqësojnë komunitetin egjiptian në Kosovë i kontribuon përmirësimit të klimës politike dhe rrit besimin e elektoratit. Gjithashtu u bisedua lidhur me zgjedhjet lokale që janë caktuar të mbahen me 3 nëntor të këtij viti, dhe në këtë rast të gjithë u pajtuan që të hartohet një plan i veprimit lidhur me zgjedhjet dhe të caktohen rolet e anëtarëve të kryesisë lidhur me këto zgjedhje.

Pas kësaj mbledhje, të gjithë anëtarët e Kryesisë vizituan pesë familjet të cilat natën e kalua i kaploj zjarri dhe pësuan dëme të konsiderueshme materiale. Familjet e pësuar nga fatkeqësia janë:

1. Gezim Qorri, 7 anëtar
2. Ramadan Maliqi, 6 anëtar
3. Fadil Podrimja, 6 anëtar
4. Besnik Neza, 6 anëtar
5. Nakije Maliqi, 3 anëtar

Kryetari i IRDK-së dhe anëtarët e Kryesisë shprehën keqardhjen për ngjarjen që ka ndodhur në këto familje dhe uruan që nuk kishte pas viktima në njerëz. Kryetari i IRDK-së iu premtoj familjeve angazhim për sanimin e dëmeve. Në këtë rast 5 familjet e dëmtuara nga zjarri u ndihmuan nga fondi i IRDK-së me nga 50 euro për secilën familje.



**M**e datën 29.07.2013 në Tiranë, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, është promovuar libri "Antropologjia Socio-Kulturore e Egjiptianëve në Ballkan" e autorit Dr.Rubin Zemon. Në promovimin e librit morën pjesë panelistet Prof.Dr.Marcel Curtiades, Prof.Dr.Armanda Hysa, përfaqësues të komunitetit të Ballkano Egjiptianëve nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe Australia. Ky manifestim u udhëhoq nga Behar Sadiku, i cili me veshjen e tij me motive nga Egjipti i Lashtë solli emocione në hapje të manifestimit. Dr.Marsel Curtiade duke e uruar autorin për botimin e librit në gjuhën shqipe solli fakte të reja që në një mënyrë e plotësojnë librin. Ai vuri theks të veçantë në konfuzionin lidhur me emërtimin e Egjiptit, Etiopisë dhe Indisë në periudha të ndryshme dhe fakte lidhur me migrimet e popullsisë nga Azia dhe Afrika në drejtim të Ballkanit. Dr.Armanda Hysa, në referimin e saj lidhur me botimin e librit vuri theksin në rëndësinë e botimit të librit të Dr.Rubin Zemon. Ajo theksoi se rëndësia e botimit të këtij libri qëndron në faktin se në gjuhën shqipe ka munguar libra etnologjik për popullsinë minoritare të Shqipërisë, së dyti, ky libër vendos bazat e identitetit etnik të Ballkano Egjiptianëve, së treti, autori i librit, edhe pse double isider, nuk e

paraqet komunitetin e tij me emocione të tepruara dhe romantike por gjithmonë duke e argumentuar atë që e shpreh. Dr.Rubin Zemon i emocionuar për botimin e librit dhe që në fillim përshëndeti dhe falënderoj pjesëmarrësit e tubuar në këtë promovim dhe pjesëtarët e IRDK lidhur me iniciativën për botimin e këtij libri. Në këtë promovim të librit folën edhe studiues nga lëmi i muzikës të cilët vënë në pah kontributin e pjesëtareve të komunitetit egjiptian në muzikën shqiptare. Pjesëmarrësve të këtij tubimi iu drejtua edhe regjisori i njohur i filmit shqiptar z.Kujtim Qashko i cili shprehu opinionin e tij lidhur me multikulturalizmin në periudhën e tanishme të globalizmit. Promovimin e përshëndetën përfaqësuesit e Ballkano Egjiptianëve nga Australia, Kosova, Berati dhe përfaqësues të tjerë.





## Njohja e së Kaluarës, përgjigje e nevojave të jetës moderne

**M**e datën 24.08.2013, Forumi i të Rinjve të IRDK-së, dega në Istog, në lokalet e komunës së Istogut, ka organizuar një tryezë diskutimi me temën "Njohja e së kaluarës, përgjigje e nevojave të jetës moderne". Pjesëmarrësit e kësaj tryezë, të cilët ishin kryesisht nxënës të shkollave të Mesme nga radhët e komunitetit Egjiptian, kanë pasur mundësinë që të njihen mbi prezencën e Egjiptianëve në Ballkan që nga periudhat e hershme të civilizimit deri në ditët tona. Kjo temë e shtjelluar nga Fazli Stollaj, zëvendës Kryesues për Komunitete i Kuvendit Komunal në Istog, është bazuar kryesisht në të dhënat shkencore të përmbledhura në librin "Antropologjia Socio-Kulturore e Egjiptianëve në Ballkan" e autorit Dr. Rubin Zemon.

Në këtë tryezë u theksua se popuj të ndryshëm për arsye të ndryshme kanë emigruar

dhe shpërngulur prej një vendi në vende të ndryshme ku me vete e kanë sjellë kulturën e tyre e cila më vonë kjo kulturë është gërshetuar me kulturat e atyre vendeve ku janë vendosur. Egjiptianët të cilët e kishin kolonizuar Ballkanin me qëllim të eksploatimit të hekurit, lanë gjurmë në këtë troje dhe sot Egjiptianët e Ballkanit të cilët jetojnë në të gjitha shtetet e Ballkanit janë pasardhësit e tyre.

Të njohësh të kaluarën tende do të thotë se: sot jeton me krenari për kulturën e paraardhësve, pasuron kulturën e Ballkanit multikulturor, mundëson shfrytëzimin e mekanizmave demokratik në vendet ku jetojnë Egjiptianët e Ballkanit me qëllim të avancimit të pozitës së tyre.

# Portë e Identitetit dhe Dinjitetit tonë Kombëtarë



**Sami Radi**

**K**ëtë libër pasi e kam lexuar në tërësi, në mungesë të ndonjë vlerësimi apo analize rreth përmbajtjes shkencore të saj, gjëja e parë që kam pas në kokën time rreth sajë është se: gjatë tërë kohës së aktivitetit ndër gjenerata duke filluar që nga fillimi i viteve të '90 jo më herët, kemi rrahë gjoks si aktivist me fragmente shkrimesh të autorëve dhe shkencëtarëve tjerë, edhe ashtu të zbehta rreth identitetit tonë.

Gjatë gjithë kësaj periudhe të historisë organizative ndër Egjiptianët e Ballkanit e sidomos në fillimet e saj, pra pothuaj klithnim më fletushka dhe fragmente që dikujt ti argumentonim prejardhjen dhe identitetin tonë, kjo pas këtij libri më ngjan si klithje dhe kërkim vrime në hulumtim të identitetit dhe dinjitetit tonë, dhe për këtë arsye vlerësimi im për këtë libër i përkufizuar në një fjali është: PORTË E IDENTITETIT DHE DINJITETIT TONË KOMBËTARË.

Ndoshta tingëllon euforike, mund të jetë edhe ashtu, por si veprimtarë që në vitet e '90 përmes vrimës kemi provuar të mbështetemi në fragmentet e: Pjetër Bogdanin, Sami Frashërit, Zija Shkodrës e shumë tjerëve, kjo libër 250 faqëshe dhe çdo njëra me argumente të fuqishme dhe lehtë të verifikueshme për prejardhjen tonë nuk mund kurrsesi tjetër ta përkufizojë vetëm si Portë e Identitetit tonë.

Si punim i parë shkencorë rreth etnogjenezës tonë në përgjithësi, sigurisht që do të thej shumë opinione paushalle që janë bërë nga

publicist dhe opinionist të popujve të Ballkanit rreth prejardhjes sonë, do të prek në qarqet e tyre intelektuale bindjen se ky komunitet ka kapacitete intelektuale që rreth trajtimit të qenies, të kujdeset vetë.

Shpresojë, apo do të dëshiroja të shpresojë, se ky libër do të jetë stimulues për shumë "intelektual" apo individë të shkolluar që të dalin nga gëzhoja e marrës për përkatësinë e tyre kombëtare në këtë rast atë: Egjiptianë të Kosovës dhe Ballkanit në tërësi, jo vetëm të dalin nga kjo gëzhojë e kalbur tani më, dhe aspak maskuese, por të japin kontributin e tyre intelektual, siç po japin shembull shumë kolegë dhe bashkëkombës të tyre.

Popullata jonë duhet të jetë krenare në arritjet për këto dy dekada e disa vite veprim të organizuar, jemi dëshmitarë të historive të popujve me të cilët bashkëjetojmë, të cilët me shekuj, dhe po thuaj shumë vonë i kanë krijuar historitë e tyre të kjarta kombëtare, me qindra vjet të sajuara edhe në rapsodi, në mungesë të njerëzve të shkolluar.

Përgëzoi dr. Rubinin dhe ata që ndihmuan që ky libër të botohet në gjuhën shqipe, shpresojë që nuk do të mungojë iniciativa e veprimtarëve tonë nga diaspora që ky libër të promovohet edhe në diasporë, si dhe avancimi jonë të shikohet në të ardhmen përmes portave të tilla e jo përmes vrimave dhe folklorizmave patriotik.



## Egjiptianizmi Ballkanas dhe Etniciteti Gjenetik

**Astrit Fetahi**

**M**e kujtohen vitet e pas luftës kur jetoja në Kosovë, për planet dhe projektet që kishte në tavolinë, shoqata egjiptiane e me vonë pastaj edhe partia politike egjiptiane. Kishte shumë ambicie në prezentimin dhe promovimin komunitetit egjiptian. Edhe pse shumë peripeci, lëvizja ka arritur shume suksese. Shumë njerëz janë integruar me sukses, dhe është arritur përfaqësim politik si në nivelin lokal ashtu edhe në Parlamentin e Kosovës. Kjo ndodhi për herë të parë në historinë e këtij komuniteti.

Lëvizja egjiptiane në Kosovë, në përgjithësi, ka bërë një punë të mrekullueshme në vetëdijesimin dhe organizimin e komunitetit. Pa dyshim, meritë të veçantë kanë udhëheqësit e shoqatave dhe partive politike egjiptiane, që drejtuan komunitetin drejt suksesit. Përkundër disa problemeve të brendshme dhe mos konsolidimit me komunitetin ashkali, duket se tash Lëvizja egjiptiane në Kosovë është e konsoliduar. Diçka tjetër që më gëzon është edhe aktivizimi i suksesshëm i të rinjve në strukturat e Lëvizjes egjiptiane por edhe edukimi i tyre. Megjithatë ende mungon një shoqëri civile e fortë që është në gjendje të thithë fonde të mëdha qeveritare dhe joqeveritare për projekte me ndikim në komunitet.

Në anën tjetër, një ngecje që ende është e evidente, është një qasje më serioze për sqarimin e etnicitetit egjiptian. Edhe pse tashmë kjo nuk ka rëndësi nga aspekti politik, pasi termi egjiptianë është pranuar zyrtarisht nga institucionet e Kosovës. Ka pasur shumë deklarime, nga ky historian apo ndonjë studiues se evgjiti në Ballkan kanë ardhur nga komuniteti i lashtë egjiptian, koptët. Apo ndonjë enciklopedi ka shkruar për këtë komunitet etj. Në mungesë të fondeve, por edhe resurseve njerëzore, Lëvizja nuk ka mundur të organizoj ndonjë hulumtim të mirëfilltë shkencor në lidhje me etnicitetin e komunitetit. Po them të mirëfilltë shkencor sepse në përgjithësi në Kosovë ka shumë pak ose nuk ka fare hulumtime shkencore. Edhe kur kam qenë student në Universitetin e Prishtinës, fjala hulumtim ka qenë pothuaj diçka e pakuptueshme në kokat e studentëve. Duke pëcjellur Lëvizjen egjiptiane, nga matanë Atlantikut, kam përshtypjen se ende etniciteti nuk është formësuar apo sqaruar si duhet. Është bërë një progres i madh në organizimin dhe vetëdijesimin e komunitetit por jo edhe në aspektin e etnicitetit. Tani, po flas në të vërtetë si një ish Ballkanas pasi që ende në këtë Gadishull, etniciteti është primar dhe është çelës duke përcaktuar paraprakisht pozitën e individit në shoqëri. Etniciteti është i një rëndësie parësore që determinon të gjitha: personin si individ, mundësitë jetësore, diskriminimin, pozitën familjare etj. Varësisht se cilit komunitet i takon individi, ai apo ajo, mund të ketë më shumë përparësi sesa pjesëtari i një komuniteti tjetër. Mund të flas më qindra shembuj pasi edhe vetë i kam përjetuar ato. Ideologjitë që kanë mbretëruar për dekada në Ballkan kanë lënë pasojat në të gjithë popujt e këtij Gadishulli. Ka qenë dashur të bëhet një punë e madhe nga një individ minoritar egjiptas si në shkollë, lagjen ku personi jeton apo në punë, vetëm e vetëm për tu ndier i barabartë me të tjerët. Me fjalë tjera, është dashur që personi të jetë i shkëlqyer në shumë aspekte për të krijuar një respekt për veten. Kjo vetëm për faktin se shoqëria ka konkluduar gjërat paraprakisht për një individ në bazë të etnicitetit që ai ose ajo i takon.

Një gjë që është karakteristike në Ballkan, është se një komunitet mendon se është më superior se tjetri. Kjo ka kontribuar në gjenerimin urrejtjes dhe nga urrejtja ka ardh nacionalizmi, dhe nga nacionalizmi edhe konflikti.



Tani pasi nuk kam jetuar në Ballkan qysh nga viti 2004, shumë gjëra kanë ndryshuar në pikëpamjet e mia. Edhe pse kjo ka filluar kur kam qenë në Kosovë si proces i ridefinimit në mendjen time. Nuk mendoj se etniciteti duhet të përcaktoj gjërat në jetë. P.sh. në Ballkan vazhdon tradita e martesave vetëm brenda komunitetit (edhe pse ka përparime në këtë drejtim). Përkundrazi, martesat e përziera, duhet të shihen si një gërshetim i vlerave kulturore. E shoh si një pasuri e popullatës që është e përzier me kultura të ndryshme. Kam pasur fatin të studioj në SHBA, dhe kjo me të vërtetë më ka ndryshuar shumë pikëpamje. Sa më shumë diversitet nëpër kampuset e Universiteteve ku kam studiuar, aq më interesante jeta shoqërore ishte. Diversiteti është njëra prej gjërave që çmohet shumë në jetën amerikane. Kjo është ajo çka e bënë një popull të fortë dhe të mbijetoj. Fatkeqësisht në Ballkan, tentativa është ende se si të krijohet një popull sa më i pastër etnikisht dhe jo i përzier. Kjo në fund të fundit do ta sjellë komunitetin e ashtuquajtur të pastër, në dështim dhe pa fuqi të vërtetë rigjeneruese. Fatkeqësia e kësaj është se njerëzit fillojnë jetën, jetojnë dhe vdesin me idenë se ato janë pjesëtarë të një komuniteti 100%. Gjurmimet historike dhe arkeologjike kërkojnë kohë, ekspertizëm, dhe shumë fonde për të hulumtuar ndonjë fenomen apo ndonjë ndodhi historike. Shpeshherë këto mbesin edhe hipoteza. Kjo e fundit do të ishte rrugë e gjatë apo e pafund për studimin e etnicitetit të egjiptianëve në Ballkan.

Fatmirësisht sot shkencë ka arritur një nivel të lartë të zhvillimit. Sot ka mundësi edhe përmes metodave tjera të bëhet studim mbi etnicitetin e individit apo komunitetit. Ajo është studimi i ADN-së apo etniciteti gjenetik. Tashmë ekzistojnë kompani të ndryshme në botë sidomos në Evropën e zhvilluar dhe Amerikën Veriore që kryejnë këto teste. Testi në fakt nuk është i shtrenjtë dhe vetëm për disa javë rezultatet publikohen dhe personi në fjalë, sipas përqindjes, e kupton prejardhjen prej regjioneve të ndryshme të botës që mund të këtë ardhë. Në fakt, studimi mund të tregoj lëvizjet e popullatës me qindra apo mijëra vite gjatë historisë. Ajo është bazë e mire pastaj edhe për të bërë hulumtime të mëtutjeshme mbi lëvizjet imigruese që janë bërë nëpër botë. Gjëja më e bukur e kësaj është se tani kompanitë e ofrojnë në mënyrë individuale dhe nuk ka nevojë për ndonjë organizim nga komuniteti. Çdo individ mund të inicoj dhe paguaj testin përmes websajtit të kompanisë që ofron këto shërbime. Është interesante të kuptohet se çka ka për të thënë shkencë dhe shpesh herë rezultatet janë edhe me befasi. Nuk besoj se në Kosovë ka mundësi studimi gjenetik i ADN-së, por se tash mendoj pa problem individit edhe nga Kosova apo jashtë saj, mund të inicoj testin nga shtëpia përmes internetit në ndonjë nga shtetet evropiane si Britani të Madhe apo ndonjë shtet tjetër. Zakonisht për analizën e etnicitetit gjenetik nevojitet mostër nga pështyma e individit dhe asgjë tjetër.

Personalisht, unë e kam bërë testin dhe kam marrë rezultatin që më kanë fascinuar. E kam bërë testin vetëm për kënaqësi individuale sepse tani nuk është kjo diçka e rëndësishme primare për mua, por është kuriozitet personal. Etniciteti është diçka që është e përcaktuar nga lindja dhe nuk është diçka sikur religjioni apo ideologji që mund të përqafohet nga individit. Besoj që jo vetëm që është personale por edhe me interes familjar. Por në anën tjetër, mos të dyshon ndokush, se ka etnicitet të pastër në planetin tonë. Njerëzimi ekziston që një kohë, dhe kam lexuar edhe studime shkencore që përputhen me mësimin teologjik se në fund të fundit, njerëzimi rrjedh nga një çift me bekimin e Perëndisë.

*afetahu@yahoo.com*



**Bislim Hoti**

## Të nderuar motra dhe vëllezër Egjiptian, në Kosovë dhe jashtë saj

Për të mos qenë të humbur, për të mos mbetur vazhdimisht në mëshirën e kohës, të nënvlerësuar e të pa strehuar, të pa punësuar e të pa arsimuar, të pa barabartë dhe të distancuar, të mashtruar dhe të pa ndihmuar, ju ftojme që të jepni kontributin tuaj në momentet e duhura, e posaçërisht kur lidershipi i komunitetit egjiptian në Kosovë e kërkon një gjë të tillë, sepse vetëm zëri politik mund të na avancoj dhe të bëjë integrimin tone në instanca më të larta shtetërore.

Politika e Egjiptianeve në Kosovë beri një hap të çmuar kombëtar që në zgjedhjet komunale të 3 nëntorit 2013, të bashkuar po marrim pjesë në subjektin e vetëm politik IRDK ( Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës ).

Gjatë punës sonë për certifikimin e IRDK, së në komisionin zgjedhor, nëpërmjet përfaqësueseve tanë në të gjitha degët, kemi qenë transparent për krijimin e listave të kandidatëve në zgjedhje, nuk kemi lënë as kënd anash pa i ftuar që ti vemi në listë, andaj nuk do të lejojmë që dikush të ankohet apo të krijoj imazh të keq për qëllime të caktuara, dhe më këtë do të ju bëjmë thirrje të gjithëve që në momentin e daljes në zgjedhje komunale, të mos i dëgjoni dashakeqësit të cilët na e kanë zilinë, mos i lejoni të na përçajnë, mbylluni derën të tillëve edhe po qe se i keni të afërt, sepse ata janë fanatik, ata janë vetvetja e jo kombi. Ata dëshirojnë emër por nuk kanë zemër.

Mos të lejojmë që të na kaploje xhelozia, ata që duan emër e kanë mundësinë që të dëshmojnë, të ofrohen në shoqëri me ne, dhe të japin kontributin për ndryshime dhe marrjen e pozitave, IRDK-ja i mirëpret personat e tillë.

Nëse e kërkonit udhëheqje dhe besimin tone, kontribuoni, dhe na e jepni sinqeritetin tuaj, largoni nga vetja ata persona që janë pa komb e pa fe, largoni dhe mos bashkëpunoni me ata persona që na sollën ndarje kombëtare, sepse do të shpërbleheni nga kjo. Kombi jeton edhe pa këta persona të llojit të tillë, ndërsa pa komb do të jemi

të humbur dhe të dështuar.

Është momenti i fundit që nga këto pësime të marrim mësim, mos ta përdorim të kaluarën duke e jetuar jetën e dikujt tjetër, por të kontribuojmë të bashkuar që ta ndërtojmë jetën tonë.

Dikush akoma nuk e vlerëson punën dhe sakrificën, por besoni se kemi bërë më tepër se sa na takon në realizimin e projekteve.

Të nderuar motra e vëllezër, ne nuk mund të jemi të kënaqur vetëm me kaq, por puna aktiviteti dhe humanizmi duhet të jetë kontribut i jonë i përbashkët dhe i pa ndalshëm që do të mbetet mekanizmi i vetëm për ta jetuar jetën tonë.

Kërkoni vetëm atë që e dhuroni, e mos e kërkoni atë që nuk e dhuroni.

Ne nuk duhet të jemi të kënaqur vetëm me at se çka marrim, por Shpërblimi më i madh i vjen atëherë me atë se çfarë japim.

Një poezi për krenarinë Kombëtare

Nuk jemi Grek e as Bullgar  
Jo as Slever, e as Shqiptar  
Asgjë tjetër ne nuk jemi  
Egjiptian etninë e kemi.

Neve këtë emër as kush nuk na fali  
Por dhuratë Zoti na e bani  
Ta gëzojmë kudo që jemi  
Se këtë emër për nder e kemi

24 qershori kjo ditë e madhe  
Më e vlefshmja ditë kombëtare  
Na jep nderë e na sjell lajm  
Se ne jemi Egjiptian

Sot të gjithë të hedhim valle  
Ti lajm anash derte e halle  
Se mjaft kem pasur kohëra të vështira  
I lutemi Zotit për ditë më të mira

autor: Bislim Hoti



## Elemente reflektimi mbi Ballkano-Egjiptianët

**Prof. Dr. Marcel Courthiade**

**N**ë prag të këtij shekulli, kur disa vizione na dukeshin të fiksuara mirë, mjaft gjëra vihen përsëri në dyshim, midis të tjerash peizazhi njerëzor i Evropës, për shembull del si pyetje nëse është e mundur “të zbulohet” në Europë një minoritet prej qindra e mijëra shpirtrash.

Kriza jugosllave jo vetëm na tregoi se po, por edhe ripruri si pyetje teorike se çfarë është një minoritet kombëtar, bile nëse ekziston apo jo një përcaktim i vetëm i këtij nocioni, i vlefshëm për çdo minoritet. Deri në mes të shekullit 19, një minoritet kuptohej si një grup që dallohej nga mazhoriteti për arsye fetare (koncept që ka mbijetuar edhe në disa treve të Jugosllavisë deri më sot), kurse më vonë, minoriteti u përcaktua me anë të etnisë, të gjuhë e të kulturës, dokeve e zakoneve. Mirëpo doli se edhe ky koncept në disa rate nuk është i mjaftueshëm për të pasqyruar të gjitha aspektet e të qenit minoritar. Ngjarjet e trishtueshme që kanë dhimbsur kaq shumë Jugosllavët kanë drejtuar dritën e aktualitetit mbi Ballkan, duke nxitur edhe reflektimin në këtë fushë: ndërsa shtypi rimerrte gati njëzëri havazin e gjoja ngatërresës shpresëhumbur e të pakuptueshme të minoriteteve ballkanike e rivendoste në modë fjalën bastarde të “ballkanizimit”, analiza shkencore tregonte se është pothuaj gjithnjë e mundur të paraqiteshin grupet etnike në një listë të caktuar, edhe pse një paraqitje e tillë ngjall shpesh mjaft diskutime, nisur nga fakti që jo rrallë numri e emri i grupeve ndryshon nga një burim në tjetrin. Pikat e mospajtimit janë sidomos të lidhura me mënyrën e trajtimit të grupeve; faktikisht ekzistojnë:

- grupe jo shumë të mëdha dhe/ose "të padukshëm", por nganjëherë autoktone; mund të flasim për minoritete punktiale për sa i përket shtrirjes së tyre gjeografike (mund të shtrihen në një, dy ose disa fshatra; është rasti për shembull i Goranëve në malet Sharr ose i Kajnasëve afër Korçës);
- grupe të tjera pa gjuhë specifike, por të konsideruara si veç nga popullsia mbizotëruese dhe/ose nga ato vete (mund të bëhet fjalë në disa raste për "kasta" në kuptimin e gjerë të fjalës) është rasti i "Egjiptianëve" që janë objekti i këtij artikulli;
- emigrantët, më të herët ose më të vonshëm;
- grupet që, sipas disa burimeve, dallohen nga njëri tjetri por që, sipas burimeve të tjera, përbëjnë vetëm një etj... (grupe me disa emërtime ose grupe shumë të afërta njëri tjetrit).

Me gjithë këto mospajtime, është zakonisht e mundur të gjendet një gjuhë e përbashkët. Plasja e luftës në Dardani (ose Kosovë, Kosova etj...) e pruri për herë të parë emrin e ashkalive, egjiptasëve, evgjitëve, jevgjëve e grupeve të tilla, të përzier pak a shumë me rromët (ende shesh të njohur si “ciganë” ose “gitanë” nga laikët). Duhet vënë dukje që termi "gitan" i kushtohet në mënyrë ekskluzive botës spanjolle e jugo-amerikane; që të flasësh për "gitanët" e Jugosllavisë është aq e saktë sa të flasësh për goranët e Spanjës... Por shushatja e gazetarëve, tani e mbështetur në këtë kuptim të gabuar të mahnitshëm nga përkthimi i një titulli filmi me famë botërore do të ishte mirë që t'i detyronte fjalorët të rishikojnë kolonat e tyre për korrigjim gjë që nuk mund të pritet nga gazetaret se nuk janë mësuar të informohen dhe të azhurnojnë njohuritë e tyre...

Njerëzit kompetentë e dinë fare mirë se fjalët rrom e cigan nuk përputhen si kuptim; vetëm disa qarqe e paraqesin fjalën “rrom” si një formë “politikisht të rregullt” për “cigan”. Marrëdhëniet midis emrave të këtij tipi e realitetit etnik nuk kanë qenë shpesh e shprehur qartë. Është ndoshta rasti këtu për ta bërë dhe të shtrojmë pyetjen: A ka një popull ballkanik i quajtur në Shqipëri jevg ose evgjit, në Jugosllavi dhe Maqedoni më shpesh Ashkali, dhe ne Greqi Êýððïë ?

## Emra, origjina, etimologji

Me sa mbahet mend, Ashkalitë (ose Hashkalitë) e kanë përcaktuar vetveten gjithmonë në Jugosllavi si një qenësi e quajtur Ashkali dhe tërësisht e ndryshme nga ajo e rromëve, edhe pse fshatarët vendalinj, në inyorancën dhe sidomos në mospërfilljen e tyre, i kanë ngatërruar shumë shpesh me rromët me të njëjtën etiketë cigani në serbo-kroatisht dhe magjup në shqip. Megjithatë, ata ishin emërtuar shpeshherë edhe me një emër të përcaktuar që kishte për rrënjë një nga format e fjalës "Egjipt" (nëpërmjet greqishtes): Gjupci, Edupci, Magjup, Jevg, Evgjit etj... ndërkohë që fjala turke që i përcakton, Kýpt, vjen prej të njëjtës origjinë, por nëpërmjet arabishtes. Dimë që një "Egjiptjan i Prilepit" firmoste më 8 gusht 1867 një apel, i botuar në gazetën "Makedonya" të Stambollit, për mbrojtjen e këtij komuniteti dhe të drejtave të tij fetare. Në të njëjtën periudhë, enciklopedisti shqiptar Sami Frashëri përdorte fjalën "Evgjiteti" për të emërtuar Egjiptin, në enciklopedinë turke prej gjashte volumesh Kamus ul alâl (1900).

Etimologjia e emrave të popujve dhe të grupeve njerëzore ka tërhequr shpesh vëmendjen e kërkimit onomastik nga pikëpamja e prejardhjes fillore, por nuk është më pak me interes të ndjekim historinë e tyre fjalëve, "udhën" e tyre, mund të themi në përdorimin e popujve, sepse ata rrëshqasin tepër lehtë nga një gjuhë në një tjetër, duke sjellë pas disa shekujsh keqkuptime, bile me kundërkuptime të rënda, të afta të shërbejnë si pretekst për barbarizama të ndryshme, siç ka qenë për fat të keq rasti për disa Ashkali në konfliktin e fundit kosovar, dhe sidomos që prej asaj kohe e më tutje.

Disa prej intelektualëve ashkali filluan të dëgjohen rreth viteve 80, duke u hequr si origjinarë të Egjiptit - pa qenë i mundur identifikimi formal i burimeve të tyre. Në ditët tona, disa pohojnë se paskan dëgjuar për këtë që nga fëmijëria e tyre nga goja e baballarëve (termi "baballarët" është në fakt i dyshimtë sepse ai emërton jo vetëm prindërit por gjithashtu autoritetet kanunore; ashkalinjtë janë shumë të dhënë pas Kanunit). Siç thonë ata, baballarët thonin se ata vinin nga "Misiri" (jena ardhë pe Misiri), por këta të fundit nuk e dinin kuptimin e fjalës "Misir" ose shihnin në të emrin e një qyteti oriental ose të një krahine të Turqisë. Më vonë, ata zbuluan se flitej për Mýsýr, dmth "Egjipt" në turqisht. Në fakt Egjipti në atë kohë ishte veç një krahinë e Turqisë otomane nëqoftëse marrim parasysh kufijtë e atëhershëm. Këtë lidhje e vërteton edhe etimologjia e fjalës magjup (< m + egjiptian ; cf. serbo-kroat jeđup "Egjiptian"). Teza më e përhapur në disa qarqe të Ashkalive pohon që prejardhësit e tyre kishin arritur në Ballkan bashkë me Aleksandrin e Maqedonisë - për të cilin, është e vërtetë që të gjithë kërkojnë një fare atësinë ose gjirësinë në këtë zonë... Ashkalitë e Ferizajt / Uroševac, të pasur, të fuqishëm nga ana politike dhe myslimanë të organizuar mirë, janë veçanërisht guximtarë në rindërtimin e tyre të historisë dhe nuk tërhiqen përballë asnjë anakronizmi, duke thënë për shembull që Aleksandri ka qenë myslimani i parë... Imagjinata e tyre nuk duhet të lerë të harrohet fakti që bëhet fjalë për një çështje me rëndësi dhe të dhimbshme për shumë persona, për një temë që ka shkaktuar vdekje njerëzish, dhe që kjo fantazi nuk është gjë tjetër veçse pasoja e inyorancës së tyre, vet pasojë e mosdijenisë së shkencëtarëve, e cilat rrjedh nga mospërfillja e tyre për këtë popullsi të përbuzur. Ata nuk kanë hallë që prek dhjetëra mijëra shpirtrash në Dardani, gati në të njëjtin numër në Maqedoni, akoma më shumë në Shqipëri dhe një numër të panjohur në Greqi, në Turqi dhe gjithashtu në Bullgari (qyteti e krahina e Modonit, në malet Rodope).

Është e qartë që bota shkencore fillimisht nuk e mori shumë seriozisht këtë etnoghenezë vetëtimë por "kohën e fundit u zbuluan në Bibliotekën Vatikane dokumente që bëjnë të besueshme që në vitet 306 deri 327 në Maqedoni kanë ardhur Egjiptianë në formën e 150 000 ushtarëve këmbësorë e 150 000 kalorësve" (Pulton, 1995:142). Ky zbulim mund të ndryshojë e zhvillojë mendimet. Elemente të tjera në favor të kësaj teze janë evidencuar nga Duijzings: zbulimi i varreve egjiptiane në malet e Stogovos (Maqedoni), afër një miniere mangani (Mn) ku sipas traditës orale, Egjiptianët paskan punuar si skllevër; ikona të tipit kopt nga Egjipti (në argjil të pjekur) qenkan gjetur në po këtë rajon; dyqane të vegël egjiptiane shtronin udhën Via Egnatia (nga Durrësi në Konstatinopol); më së fundi festat e mëdha e Ashkalinjve (të paktën në Maqedoni) janë Shën Naum e Shën Athanas, fetarë në Aleksandri në shekullin e katërt. Së fundi, Marko Lopusina, i përmendur nga Robertina Ašuri dhe Rubin Zemon (1996:67) flet për një akt pronësie të nënshkruar në Strugë më datën 5 të muajit Ramadan 1295 (nuk qartësohet sipas cilit kalendar) midis Arabësh e Koptësh, të quajtur bij të diellit, pasardhës të Egjiptianëve hemitë që nuk e kishin pranuar asnjëherë islamizimin.

Sot, egjiptasët mbështeten në burime shumë më të hershme për të forcuar tezën e pranisë së tyre në Ballkan që para erës sonë, veçanërisht në një ekstrat të Herodotit: "Në Maqedoni Fenicianët e hershëm shfrytëzonin minierat e arit, që shkrihej në një furrë të posaçme, para ardhjes së kolonëve egjiptianë" (përmendur nga Rubin Zemon, president i shoqatës ballkanike të egjiptasëve). Burime të tjera flasin për dymbëdhjetë rrugë të Athinës të banuara nga egjiptianët që praktikonin zanatet e tyre tradicionale.

Tempuj de Izis janë zbuluar në Ohër (më parë Lyhnikos) dhe në Bitolë (Monastir, më parë Heraklea) dhe një vulë që tregon zhuzhingën legjendare është gjetur në rajon. Është e qartë që vazhdimësia midis kësaj pranie kaq të hershme të diasporës së një populli prestigjioz dhe kujtimeve të paqarta të një popullsie pjesërisht të anësuar, është e vështirë të vendoset. Teza për një ardhje të tyre në shekullin e katërt (burimet vaticane të zbuluara nga Hugh Poulton) pas persekutimeve kundër koptëve e qartëson skenën historike, nëqoftëse imagjinojmë që kontingjenti i shekullit të katërt erdhi në Ballkan për t'u ngulur atje, duke ditur nga kolonët e përparme me të cilët ata kishin ruajtur marrëdhënie, që mund të gjenin një strehë në trevat ballkanike. Por në mungesë dokumentacioni, hipoteza të tilla i përkasin më tepër rishkrimit të historisë sesa historiografisë e njohim çfarë gjëmë mund të shkaktojnë prirje të tilla, kur ka pretendime ta zëvendësojnë historinë.

Në entuziazmin e tyre, disa do të pretendojnë që egjiptianët e hershëm kishin shqipen si gjuhë kombëtare, që nënshkrimet e tyre nëpër piramide në Egjipt duhen interpretuar në bazë të shqipes dhe jo prej gurit të Rosetës (puna gjeniale e Shampolionit do të konsiderohej atëherë si "gjithçka jo të saktë" - por është e vërtetë që ata që shkruajnë fantazira të tilla nuk njohin as ekzistencën e Shampolionit dhe as atë të gurit të Rosetës) dhe që janë paraardhësit e tyre që sollën shqipen nga Egjipti në Shqipëri, ku ua mësuuan Ilirëve. Edhe në kontekstin e injorancës përvëluese ku janë shkrirë e rishkrirë shumica e rindërtimeve historike të Ballkanit, thënie të tilla janë hutuese. Megjithatë për të shfajësuar Ashkalo-egjiptasët, duhet theksuar që ata nuk janë autorët e këtyre legjendave : ato u lëshuan nga një i ashtuquajtur filolog italian me origjinë arbëreshe, Xhuzepe Katapano, që mbas 20 vjet "kërkimesh", botoi në 1948 që faraoni "Thot-Tat fliste shqip" dhe që "shqipja përdorej në Egjipt që prej 10 000 vjetësh para erës sonë". Vetë zoti Ismail Kadare e solli më vonë këtë anekdotë në javoren Drita pa bërë në të vërtetë ndonjë kundërshtim dhe pa ironizuar mbi këto trillime. Si atëherë të kritikosh intelektualë fillestarë që mbështeten mbi këto grimca legjendash, në një kohë kur me shekuj identiteti i tyre është i mohuar, i mbytur, i asfiksuar, në një kohë kur ata vetë përbuzen nga rrethi i tyre ?

Përsa i përket etimologjisë së emrit Ashkali, ajo duket thjesht shqiptare: ashke "karbon druri" (arkaik për shqipen moderne eshkë "id"), e ndjekur nga një prapashtese turke li, lý, lü, lu që do të ishte një emër zanati që sjell ndërmend farkën dhe lëndën e saj djegëse - metafora a > e është vërtetuar për një numër të konsiderueshëm leksemash, siç e tregon gjuhëtari shqiptar Eqrem Çabej (1908-1978) në Fonetikën Historike, Prishtinë 1976, vol. 3 fq. 115. Disa etimologji të tjera janë vënë përpara, njëri prej të cilave do t'a përmendim këtu, mbasi tregon një fantazie të rallë: "Ajt shko ne Itali" > Ashkali - e përmendur megjithatë në një broshurë të mirë kolektive të Minority Studies Society të Sofies (sh.bibl).

## Krijimi i shoqatave egjiptiane

Në vitet 90 u shumëzuan në Jugosllavi shoqatat e egjiptianëve (Egipæani), dhe më pas të Ballkano-egjiptasëve, të shqiptaro-egjiptasëve për ata më shqiptarofilë etj... më shpesh konkurrenca për shkak të grindjeve e ambicioneve vetjake, duke lënë të kuptohet që flitej çdo herë për etni të veçanta.

Paradoksalisht, shoqatat që morën emrin tradicional Ashkali u krijuan të fundit - thjesht për faktin se ky emër, i vetmi i vërtetuar në terren prej shekujsh, u referohet Ashkalinjve më pak të shkolluar, fshatarë dhe zanatçinj, që nuk ndjeheshin të prekur nga lëvizjet e përkatësisë etnike. Lëvizja u nis nga Maqedonia (Bitola dhe Ohri veçanërisht). Në 1990, Nazmi Arifi krijoi shoqatën egjiptiane të Ohrit, me 4000 anëtarë. Në të njëjtin vit dhe vitin më pas, ata vendosën marrëdhënie me ambasadorin e Egjiptit në Beograd, fillimisht i çuditur ai dhe pastaj i bërë për vete, deri në atë masë sa Egjipti financoi nga vendi i tij ndërtimin e një xhamie ashkalinjsh në Ohër. Në 1991 ata botuan një përmbledhje legjendash, tregimesh dhe gojëdhënash.

Përparësia e pranisë së tyre në krahasim me atë të romëve është e vërtetuar me faktin që romët (psl. Gurbetët e Mitrovicës) i quajtën Arliura (< turqisht yerli "vendës, autoktone, sedentar", në vend të fjalës Ashkali, term i përdorur nga romët të tjerë, më në jug), gjë që provon që Gurbetët i gjetën aty kur erdhën në krahinë ; po ashtu, romët Meçkarë e Shqipërisë së mesme dhe të jugut u japin të njëjtin emër, në formën 'Rlie.

## Rrënjët e identitetit

Disa vëzhgues të huaj e interpretuan shfaqjen e këtij identiteti të ri si një strategji e disa "ciganëve" për të shpëtuar nga damka e lidhur me emrin "cigan". Në të vërtetë, fjala "cigan" (cigani, magjup) përfshin në të njëjtën kohë rromët dhe ashkalinjtë, kurse nga ana tjetër nuk ka asnjë damkë të lidhur me fjalën rrom, përkundrazi, derisa ajo lidhet me vullnetin e Titos të emancipimit dhe të zhvillimit të këtij populli, në kuadrin e të famshmes "bashkësi-vëllazëri". Mënyra më e mirë për t'i shpëtuar damkës do të ishte atëherë adoptimi i emrit "rrom", një emër me prestigj, dhe mbështetja mbi kapitalin politik të fituar prej vitesh. Përkundrazi, kërkesa dhe afirmimi i një origjine egjiptiane i referohet fare qart nocionit "cigan" - në serbo-kroatisht dialektal Eđupci, Gopti, Gipteri (< Aiguptos)... Përsa i përket afirmimit si Ashkali, ky nuk është, nga kjo pikëpamje, veçse vërtetimi i etiketës magjup. Duket domethënë, që Ballkano-egjiptianet që u pohuan si të tillë, dhe akoma më tepër si Ashkali, iu bindën një ndjenje identitare të thellë dhe jo çfarëdo oportunitizmi politik.

Në të vërtetë, këta vëzhgues të huaj nuk dalin dot prej bllokimit sipas të cilit "rrom" është thjesht formula politikisht korrekte për "cigan", gjë që gabon gjithë vazhdimin e analizës së tyre.

Në Ballkan, Ashkalinjtë e Dardanisë dhe të Maqedonisë nuk janë të vetmuar dhe me sa duket evgjitet ose jevgjit (< Aiguptos) e Shqipërisë janë etnikisht të lidhur me ta, e njëjta gjë për Kuptoi të Thrakisë (të ripagëzuar para dhjetë vjetësh nga gjendja civile greke "mahomedallinj") dhe Kýptët e Turqisë. Kronologjia e ardhjes së tyre mund të shpjegojë nga ana tjetër emërtimin e mëvonshëm të rromëve si "egjiptianë". Disa shekuj mbas ardhjes dhe vendosjes së këtyre egjiptasëve-ashkalinjve, fshatarët e Azisë së Vogël, duke parë ardhjen e Rromëve, nga i njëjti drejtim, të riaktivuan, për t'u dhënë një emër, etiketën "egjiptianë" - prej kësaj rrjedhin termat serbo-kroate të përmendura më lart, që afërsohen me Firauni, Gypsies, Gitanos etj... jashtë Ballkanit. Rromët shumë herët vunë re se identiteti egjiptian ishte për ata më me leverdi sesa identiteti i vërtetë indian, kjo për arsye të prestigjit të madh të Egjiptit në këtë periudhë dhe për arsye të ndryshme politike (konflikte islamo - krishterë) dhe filluan ta përdorin për t'u paraqitur nëpër oborret mbretërore të Evropës, duke fshehur (ose gati) origjinën e vërtetë të vendit të tyre - deri në rizbulimin e rrënjëve të tyre të vërteta nga krahasimi gjuhësor në fund të shekullit të XVIII (elemente të ndryshme na lënë të kuptojmë në të vërtetë që harresa nuk ka qenë asnjëherë e plotë).

Përsa i përket gjuhës, Ashkalinjtë dhe jevgjit janë folës të shqipes brez pas brezi, ndërsa Kuptoi dhe Kýpt kanë me sa duket turqishten si gjuhë shtëpie (në rajonin e Athinës, me veçanërisht në lagjen Gazi, ata përcaktohen, nën presionin nacionalist ortodoks mbizotërues, si "Grek turko-folës" sepse një identitet i trefishtë, mysliman, turko-folës dhe egjiptian do të ishte faktikisht tepër i rëndë të mbahej në një kontekst disi ksenofob). Nga gjuha e tyre e lashtë, nuk mbetet më asgjë, ndoshta për arsye të faktit që kanë dalë nga një emigrim burrash që kanë marrë gra ballkanike. Në fakt, jevgjit e Shqipërisë kanë disa terma dialektore të veçanta, dhe gjashtë prej tyre të marra nga rromët, por gjithashtu një kuriozitet të veçantë: formula aspi çoçe "qepe, po na degjojnë" që mund t'i afrohet gjuhës kopte aspe "gjuhë" dhe xoxhe "i huaj, armik"... Në të vërtetë, karakteri i vjetër dhe melodia e të folurës së tyre i karakterizojnë në mënyrë të veçantë; bile atyre u pelqen t'i theksojnë këto karakteristika për të bërë shaka.

Integrimi i fortë i Ashkalinjve të Dardanisë në botën shqiptare është tepër i dukshëm: që nga anëtarësia e rreptë në Kanun (e drejtë zakonore e malësoreve shqiptarë) deri në angazhimin e tyre në UÇK apo afër saj si mekanik agregatësh, kuzhinierë, hamallë etj. Ne Klinë, një familje ashkali ia dha vilën e saj UÇK-së, që kjo e fundit të vendosë qendrën e saj. Të zbuluar ata u detyruan të largohen në Francë, ndërsa tanket serbe e bënë shtëpinë pluhur e hi.

## Ashkali versus egjiptasë të Ballkanit

Ndarja midis Ashkalive dhe egjiptasëve të Ballkanit nuk mund t'i rezistojë vëzhgimit familial, ku pleqtë vazhdojnë të quhen me emrin lashtësor Ashkali, ndërkohë që të rinjtë, nëqoftëse janë të politikuar dhe domethënë të zënë keq nga damka e prapambetjes shpeshhere e lidhur me këtë fjalë, preferojnë të kualifikohen si egjiptasë. Është kjo arsyeja për të cilën neologjizmi Ashkaloegjiptasë ka është propozuar mjaft herë si identifikues i qartë. Në të vërtetë, autoritetet shqipëtare i konsiderojnë në Tirane egjiptasët si "pjesë të pandarë të trungu shqiptar, por me prejardhje të veçante", për arsye të lashtësisë së shkrirjes së tyre në kombin shqiptar, të mungesës së një gjuhe të vetën dhe ajo çka hidhet poshtë nga Ashkalo-egjiptasët të mungesës së një kulture specifike. Pavarësisht nga deklaratimet e zyrtarëve, përbuzja nga vuajnë evgjitet/jevgjet nuk lë vend që të konsiderohen të barabartë me Shqiparët e tjerë. Për pjesën më të madhe të të interesuarve në fakt, ka barazi kuptimore midis emrit popullor Ashkali dhe "të riut" egjiptas, siç e tregojnë këto vargje të një poeme të Rrahman Miftarit, redaktor i revistës "Ekot e egjiptasëve kosovarë në diasporë":

Jam egjiptas  
 Me fe mysliman  
 Festa ime e devotshme është Bajrami  
 Dhe agjerimi Ramadani  
 egjiptasë dhe Ashkalinjemi i njejtë gjak

E njëjta vëllazëri. (shih tekstin e plotë me larg).

Për çudi, ndërsa identiteti egjiptas/ Ashkali nuk ka më asnjë dyshim për pjesën më të madhe të tyre, përsëri shohim të huaj, më veçanërisht disa aktivistë që nuk janë as egjyptianë, as Ashkali, as rromë, bile shpesh as origjinarë të krahinës, të ndajnë egjyptianët dhe Ashkalitë në dy grupe. Ata pretendojnë se respektojnë në këtë mënyrë një vullnet që në të vërtetë ka qenë i shprehur vetëm nga disa individë, shqetësimi i të cilëve ka qenë të vendosin shpresat e tyre për karrierë në shahun etnik të krahinës, siç e kemi përmendur në artikullin e mëparshëm me shumëzimin e përcaktimeve: shqiptaro egjyptianë, Jugo egjyptianë, Egjiptas, por gjithashtu Esnafë (në të vërtetë “mjeshtra zanatçinj”) ose më së fundi Milet (“kombësi”). Për të parafrazuar shprehje mjaft të njohura, mund të themi për këta shumëzues të identiteteve që ata duan të jenë “më egjyptianë se Ashkalitë”.

Ashkalo-egjiptas (ose Ballkano-egjiptas) versus rrom

Nga ana e tyre, Evropa dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke besuar se bënë një vepër të devotshme që nga largësia e zyrave e tyre, duan të detyrojnë këtë popullsi të hyjë në kornizën e identitetit rrom, kjo për të riaktualizuar pikëpamjen jo vetëm të rremë, por edhe raciste, të një popullsie “cigane”, e revizuar, e korrigjuar e e rrikuar me fjalën politikisht korrekte “rrom”, në një kohë që rromët dhe Ashkalo-egjiptasët nuk kanë asgjë tjetër të përbashkët përveçse vuajtjes prej një përbuzjeje të njëjtë nga popullsitë përreth gjendje në të cilën ata nuk janë të vetmit. Gati të gjithë identitete në Evropë vuajnë ose kanë vuajtur nga përbuzja e të tjerëve. Është pikërisht kjo përbuzje e përbashkët që kërkohet në këtë mënyrë të ngrihet si identitet “kombëtar” i kulluar, me një ndërrim të thjeshtë etikete... Kur shkenca e tradita tregon se këto popuj nuk kanë kurgjë të përbashkët në histori, kulturë e vetëdije e kur nga ana tjetër janë bashkuar në një thesë nga katunarët analfabetë, nuk ka pse t'i besojmë analfabetët e të injorojmë vetëdijen e personave apo të dhënat e shkencës. Ballkano-egjiptasët kanë shumë më tepër të përbashkët me Shqiptarët sesa me rromët. Pavarësisht, të trajtosh këtë popullsi vetëm si shqiptarë “të rrënjosur” është veçse një ëndërr politikisht korrekte, sepse kjo do të thotë të neglizhosh ose të mohosh përbuzjen e përditshme nga e cila ata vuajnë. Do të ishte më mirë pra që t'u jepej atyre një statut prej minoriteti historik dhe të vlerësohet identiteti i tyre duke e bërë më të njohur, sidomos me kërkime dhe me shkollim, në mënyrë që të luftohen moskuptimi e mospërfillja ndaj tyre. Shumë intelektualë Ashkalo-egjiptasë kanë bërë udhëtime në Egjipt për të kërkuar rrënjët e tyre, sapo kanë pasur mundësi.

Ngatërrimi midis Ashkali dhe rrom, i marrë si një “eufemizëm” i thjeshtë në vend të fjalës cigan dhe jo si koncepti rrënjësisht tjetër siç është në fakt, tashmë u përhap e tejkalon përdorimin nga fshatarët e krahinave jugosllave, përderisa e ndeshim gjithashtu në mjaft raportet ndërkombëtare. Mund të përmendim disa shembuj: një vëzhgues hungarezë u dërgua në 1994 në Tiranë nga Qendra Evropiane e të Drejtave të rromeve (sipërmarrje e miliardërit György Soros) për të anketuar mbi situatën e rromëve. Megjithë takimet e shumta me përfaqësuesit rromë dhe evgjitë të Shqipërisë, që i kishin shpjeguar qartësisht situatën, ajo ironizoi në raportin e saj mbi atë që ajo quante: “kulti narcisik, siç thoshte Frojdi, të diferencimit të vogël” midis këtyre dy minoriteteve. Ajo i lejoi vetes të asimilonte evgjitet e Shqipërisë me Magyar Cigányok të Hungarisë (rromë hungarezë, të ardhur atje në Mesjetë e që kanë harruar rromishten për shkak të persekutimeve të shekullit të XVIII domethënë të konsideruar si “ciganë të mirë hungarezë, të integruar mirë, të respektueshëm”) dhe rromët e Shqipërisë me Oláh Cigányok të Hungarisë (rromë të ardhur në shekullin 19 në Hungari, të cilët flasin një rromishte të shkëlqyeshme domethënë të konsideruar si “të huaj, të egër e të paintegruar mirë”). Në të vërtetë, pothuaj të gjithë rromët dhe pjesa më e madhe e evgjitëve janë deri më sot të integruar mirë në shoqërinë shqiptare, në një rrjet të gjerë miqësie dhe komshillëku të mirë (edhe pse vështrohet prej disa vitesh një degradim social për arsye të vështirësive ekonomike) dhe pjesa e integruar jo mirë duhej kërkuar midis disa evgjitëve. Nën regjimin e Enver Hoxhës vetëm evgjitet mund të shiheshin si lypsa në rrugë, kurse rromët filluan të lypin vetëm nga fundi i viteve 90 dhe më shumë në Greqi sesa në Shqipëri. Nga ana tjetër, një numër i madh i evgjitëve ishin plotësisht të padukshëm dhe punonin në ushtri, nëpër ministri, në spektakël etj... dhe askush nuk mund të shquante identitetin e tyre nëqoftëse nuk zbuloheshin nga ata vetë ose nëse nuk njihej familja e tyre.

Një tjetër shembull mjaft i trishtuar është i lidhur me rrëzimin e “piramidave financiare”, këto hajdutllëqe që e çuan në mjerim ekonominë shqiptare në vitet 90. Njëra prej tyre ishte ngritur nga një evgjite, zonja Maksude Kalemi, e quajtur “Sudja” bile ky është dhe emri që ajo i kishte vënë piramidës së saj. Ajo e ngriti si person, si individ e në asnjë mënyrë si evgjite, njësoj si disa Shqiptarë kishin ngritur edhe ata si individë. Mirëpo një gazetari francez ju shpjegua kjo çështje nga një ndërmjetës lokal që përkthente me fjalor në dorë dhe rezultati që një artikull në gazetën “Le Monde” i 4 Janarit më pas, që ironizonte mbi “miletin endacak” dhe ilustronte nga një karikaturë ku ndesheshin qartë duart e një shtrige, një kala me letra bixhozi, karavane rromësh shtegtarë dhe simbole të tjera raciste. Të interesuarve që protestuan, mediatori i gazetës “Le Monde” iu përgjigj që ata nuk kishin humor. Lajmi erdhi në Tiranë, nëpërmjet shtypit shqiptar, dhe disa javë më vonë, kur rromët e shkatërruar nga piramidat dolën duke manifestuar kundër tyre, u rrahën nga njerëzit të cilët u indinjuan duke parë këta “hajdutë të njohur” të ankoheshin për fatin e tyre.

Edhe më përpara, ngatërrimi sundonte mbi këtë subjekt, që nga kujtimet konfuze të Margaret Hasluck rreth viteve 30 (kjo aventuriere angleze, që nuk dinte as shqip as rromisht, ka mbetur megjithatë një burim i përmendur gjithandej nga gaxhet), deri në një artikull të vetë Enver Hoxhës “Të përbuzurit janë bërë të lumtur”, ku në përgjigje kundër sulmeve raciste të kryeministrit të tij Mehmet Shehu ai deshi, njëzet vjet më vonë, të rihabilitonte rromët: një rihabilitim i çuditshëm ku, në vend që të quante rromët me një nga emrat e shumta që ata mbajnë në Shqipëri, duke përfshirë “rromë” i quan jevgë, duke kujtuar ndoshta që kështu bënte një eufemizëm e nuk i prekte në sedër... Megjithatë është e qartë se ai flet për rromët dhe jo për egjiptasët, meqenëse në artikull ai përgënjeshtroi origjinën egjiptiane të tyre, thotë se vijnë nga India dhe shpjegon dashurinë e tyre për muzikën indiane.

## Aneksionizmi rrom, shkaqet

Udhëheqësit rromë, të dëshpëruar nga këto amalgama dhe manipulime, u përgjigjën - kundër çdo prove - që Ashkalinjtë janë shpikur për të zvogëluar numrin e rromëve - dhe në këtë mënyrë t'u krijohet autoriteteve mundësi “të përçajnë për të sunduar”; këta udhëheqës, që e dinë fare mirë nga përvoja e tyre e lagjes kush është rrom e kush është Ashkali, ishin sigurisht të obseduar nga kuotat (po klujuè), që në kohën e Titos lejonin ngritjen sociale kolektive sipas përqindjes së kombëve e kombësive në popullsi, por gjithashtu hapnin shteg manipulimeve të shumta.

Në të vërtetë, kështu kuptohet mosbesimi i udhëheqësve rromë kundër daljes eks nihilo të një identiteti të ri në fushën politike, kur dimë përpjekjet e manipulimit të vërtet nga ana e Beogradit: kështu, në një intervistë në Spiegel (15 Tetor 1990) Slobodan Milosheviç deklaroi që “më shumë se gjysma e shqiptarëve të Kosovës nuk janë shqiptarë por janë në fakt egjiptasë të fshehur dhe të detyruar nga presioni i shqiptarëve të braktisin identitetin e tyre”. Në fakt, ajo që është tipike për mashtruesit nuk është të krijojnë përralla nga hiçgjë por të marrin fakte reale dhe t'i shtrembërojnë, t'i modelojnë ato për leverdinë e përfitimin e tyre. Këtë bëri ish-diktatori serb kur përfitoi nga prania e vërtetë e egjiptasëve në Ballkan, jo për të zvogëluar numrin e rromëve, por atë të shqiptarëve, duke fryrë numrin e Ashkalinjve. Ajo që ndërlikon gjërat, është se një numër i vogël familjesh rrome nuk zotërojnë më, për arsye të ndryshme, gjuhën rrome dhe disa rromë të tjerë, të cilët e ruajnë mirë gjuhën, asimilojnë këta rromë të çkulturuar me Ashkalinjtë, duke justifikuar në të njëjtën kohë përhapjen e tezës se egjiptasët janë rromë të çkulturuar, madje të manipuluar nga shqiptarët - kjo sigurisht kundër dëshirës të të interesuarve.

Përtej këtyre vërejtjeve, ajo që është e padiskutueshme, është që martesat midis rromëve dhe Ashkalinjve janë më të shumta se midis rromëve dhe shqiptarëve për shembull e rrjedhimisht ekziston një numër familjesh të përziera (kur gruaja është Ashkalikë, ajo mëson sistematikisht rromishten) dhe që një lidhje është krijuar kështu përmes krushqive.

## Kulture gojore ballkano-egjiptase, tregime, proverba dhe këngë

Por le të japim shembullin dhe le t'i hedhim një sy kulturës ashkalo-egjiptase: nëqoftëse askush prej tyre nuk duket të mendojë seriozisht për të rigjetur gjuhën e Egjiptit të lashtë (megjithëse ka pasur disa ëndrra për të ringjallur egjiptiançen e vjetër ose koptishten - të mbetura pa vazhdimësi dhe të bëra të panevojshme nga pohimi fantazist se Thot-Tati flaskishte shqip...), disa pohojnë ekzistencën e një pasurie kulturore të veçante: Stojan Risteski ka botuar një përmbledhje me “tregime popullore, tradita dhe doke tek egjiptaset në Maqedoni” (Ohër, 1991) ndërkohë që Rubin Zemon ka drejtuar botimin e një “Përmbledhje studimesh mbi etnogjenezën e egjiptaseve në Maqedoni” (Shkup, 1996 - në maqedonisht) dhe ka ekspozuar pozicionin e tij në “Egjiptasët e Ballkanit: e vërteta mbi egjiptaset e Kosovës dhe të Metohisë” (Ohër, 2001 - në serbo-kroatisht, paraqitur në Këshillin e Evropës).



Por influenza reciproke midis kulturave të popujve të Ballkanit është e tillë që duket pa bazë të pretendosh të gjesh një element kulturor që të jetë i veçantë i njërit apo i tjetrit nga këto komunitete që bashkëjetojnë prej shekujsh me këtë shpirt kom<sup>o</sup>uluk-u dhe me një vëllazëri që shekuj me rradhë ka tejkaluar limitet etnike (dhe e cila ka shumë vështirësi, nga ana tjetër e në kushtet e sotme, të mbrohet nga pikëpamjet nacionaliste të importuara nga Evropa Veriore). Megjithatë është rasti këtu të botojmë një përmbledhje proverbash të mbledhura nga Lumia Osmani-Kuç, një gazetare e re nga Prishtina (lagje e Moravës) e martuar sot në Varshavë. Poetja në kohen e saj (në gjuhë shqipe), Zonja Osmani-Kuç, që është me baba rrom dhe nënë ashkalikë, është krenare për identitetin e saj. Siç shihet, një numër proverbash janë evropiane, madje edhe botërore, sepse ata shprehin një urtësi dhe një përvojë njerëzore universale. Midis me karakteristikeve, mund të përmendim Fol për ujkun, ujku mbas dere; E more ngoje qenin, beje hazer shkopin... që gjendet praktikisht në të gjitha kulturat, vetëm emri i kafshës ndryshon (për Japonezët për shembull është një ari...; mund të themi si konkluzion që ka pa dyshim një bazë për këtë thënie); të tjerat janë pak a shumë të njohura tek shqiptarët.

Përsa i përket këngëve popullore, disa autorë, dhe veçanërisht Anastas Primovski në Bullgari dhe Emin Mamudovski nga Kìçeva në Maqedoni, kanë përmbledhur një numer të tyre, që mbeten nga më të preferuarat për Ashkalo-egjiptasët por përmbajtja e tyre nuk dallohet në asgjë nga ajo e teksteve të etnive përreth, me vajza për të martuar, të dashur të rënë në luftë, nëna të deshpëruara etj... Përsa i përket muzikës, sharkija, një lloj mandoline e madhe, konsiderohet si instrumenti i tyre i preferuar, por ky instrument gjendet edhe në orkestrat e tjera tradicionale.

### **Krijim letrar modern**

Duke parë vështirësinë për të përmbledhur një letërsi gojore egjiptase në kuptimin e mirëfilltë të fjalës - temat që vinin nga brigjet e Nilit mungojnë tërësisht, m'u duk më me interes, si dëshmi e mendimit të këtyre grupeve që pretendojnë një identitet emergjent, të paraqes krijmtaritë e aktivistëve bashkëkohorë në përshkrim letrar. Varfëria e stilit, më afër deklaratimit politik sesa krijimtarisë letrare, na lejon një përkthim të thjeshtë, pra besnik ndaj origjinalit:

#### **Jam egjiptas**

Unë jam egjiptas / Me fe jam mysliman / Feste fetare kam Bajramin / E gjijoj unë Ramazanin.

Egjiptas e Hashkali / Jem një gjak edhe vllazni / Tjetër kush na ka shti / Që janë shkru shumë Hashkali.

Shumë është seri dhe çudi / Shumë janë shkru Hashkali / Hashkalija nuk është komb / argumenti po na tregon.

E flas shqipen po s'jam shqiptar / Me gjuhë tonën këtu kemi ardhë / Kjo si shkon diku për shtati / Shqip ka fol dikur mbreti THOT-TATI.

Jemi zeshkana po edhe të bardhë / Prej Misirit këtu kemi ardhë / Pleqtë kanë thanë edhe po thojnë / Argumentet po na tregojnë.

Rahmon Miftari (lindur më 1939 në Trudë afër Prishtinës)

#### **Jam krenare që jam Kosovare**

Jam krenare që jam Kosovare / Me origjinë Egjiptase jam / Të mburremi që këtë komb e kemi / Me tradita dhe kulturë të lartë / Kështu e njeh gjithë bota mbarë.

Deri më tani nuk dija se kush jemi / Kah vemi / Por tani lindi dielli edhe për ne / Të mburremi me këtë komb që kemi / Me plot merita, komb të mirë me fe.

Kam vuajtur më parë / Kur kam shprehur tjetër komb / Që atij nuk i takoj / Në zemër kam pasur një plagë të rëndë / Por edhe tash nuk është vonë / Të krenohemi me prejardhjen tonë.

Jam krenare që jam Kosovare / Me origjinë Egjiptase jam / Jam krenare në çdo hap / Që ardhmërine e lumtur / Të kenë edhe femijët tanë.

Në çdo hap në çdo vend / Ka dëshmi e argument / Për kombin Egjiptas / Që i takojme / Krenohem me kombin tonë / Me simbolin e piramidave së bashku me Kosovën / Zemrat tona ndriçojnë / gjithmonë do të jetojë / Atdheun kurrë s'do ta harrojmë / Jetën për të do ta flijojmë / Për të tjerët shpresojmë / Se në fund do të kuptojnë / Do të binden me të vertetë / Se nuk jemi asgjë tjetër / Kemi prejardhjen shumë të vjetër / Bashkë me Ilirët ne jetuam / Me një gjuhë komunuam / Në ato treva ku ne jetuam / Të gjitha të mirat i kultivuem / E në fund vëllazër e motra / Më shpetoi loti / Sa i përket gjuhës / Ka folur Thoti / E tash historianët shqiptarë / Prandaj gjithë të jemi krenarë / që jemi Egjiptas e Kosovarë.

Ilmie Kongjeli

## Egjiptasët në Ballkan

Peshku i madh han më të voglin / Kur gjithçka shkon mirë, kur ai është me inat. / Ai do gjithmonë ti uzurpojë / dhe nga krimbi nuk i dallon.

Nëpër Ballkan janë shpërndarë / Brunët e lashtë egjiptianë / Popujt e bardhë i njohin keq / Ngaqë nuk i dallojnë nga romët.

Egjiptasët në Ballkan / E dinë të gjithë se cilët janë / As romë, as shqiptarë, / Popujt e bardhë i uzurpojnë.

Rahmon Miftari (përkthyer nga serbishtja)

### Klani i im i trishtuar

Vite nënshtrimi, vite shtypje / Ju keni kaluar si një lumë / Që ndjek luginat / Kujtime të rënda me trishtim / Ju keni lënë nga mbrapa. / Sopote dhe Rosoman / Në mendje rrijnë tek unë. / Sytë plot me lotë / Familja ime e uritur / Ne kemi ndjekur bashkë Barabaras, / I shkreti klani im i trishtuar / Si një anije e mallkuar / A ka parë humbjen e rinisë së tij / Në këto vjelje të lodhshme / Qiejt blu, dëshirë e madhe / Ata mbetën zanatçinj të fesë së tyre. / Vizitoni tani vogëlushet e mi / Hapësirën e botës / Me fëmijët tuaj / Dërgojeni gjithandej me besë dhe kurajo dashurinë krijuese / Për tokën e bollshme.

Emin Mamudoski (përkthyer nga maqedonishtja)

Mund të afrojmë me këto tekste poemën e mëposhtme, që nuk është shkruar nga një Ballkano-egjiptas, por nga Selahedin Kryeziu, autor rrom nga Prizreni, në shkurt 1993 (marrëdhëniet midis rromëve dhe Ashkalinjve janë veçanërisht të ngushta në qytetin e tij) që shpreh mire:

### Kush jam ?

Më pyesin se kush jam / S'di se çfarë t'u them. / Në shtëpi flas gjuhën shqipe / Vetëm se shqiptar nuk jam / Thonë se jam Egjiptas / Vetëm se nga Egjipti s'kemi as gjuhë, as zakone / Kush jam unë dhe unë pyes veten / Mijtë e mi janë më shumë rromë / Por ne nuk jemi rromë / Dasmën e bëjmë si ata / E shpesh gjithashtu me ata / Vetëm se nuk dimë gjuhën e tyre / Gjyshi im as gjyshi i gjyshit tim / Dhe të gjithë paraardhësit e mi / As ata nuk e dinin / Nuk e di se kush jam. / Ndoshta deri sa të vdes / Nuk do të di se kush jam / Mendoj që nuk ka njerëz të tjerë në botë si ne / Asnjë që nuk e di se kush është / Asgjë nuk di, asgjë për të kaluarën time / Nuk e di nga vij, / Nuk e di kush jam. / Dhe pse nuk e di - as këtë nuk e di.

## Pikëpamja e popujve përreth

Vihet re që, nga Bullgaria në Shqipëri, egjiptasët e Ballkanit janë të famshëm për megalomaninë e tyre meqënëse në bullgarisht thuhet "Agyupti, kur u bë mbret, fillimisht vari të atin", në shqip Kur u bë jevgu pashë, vrau babën e vet madje edhe në rromisht Kana avilo o Rlia bej, mudarda pe dades "id". Thuhet gjithashtu për ta që nuk dijnë të bëjnë ekonomi shtëpiake: Kana o Rlia pelo k-o khil, makhla pe pele. "Kur egjiptiani ra në gjalpë, u lye nga poshtë". Një karakteristikë tjetër që populli i ngjit atyre është frika: "zemër Agjupi" do të thotë pulë e lagur në Bullgari dhe shqiptarët pretendojnë që nëna evgjite këshillonte djalin para se të shkonte në luftë Vre kho, të keqen nona, bëni dredha plumit, mçifu mas gaxhoit ! Një anekdotë shpreh të njëjtin stereotip duke shpjeguar origjinën e shprehjes së çuditshme "ha zemrën e bardhë te jevgut": Ky kishte shumë frikë nga arinjtë. Një natë ngrihet, del e ecën pa vënë re, nën një sitë që e godet duke u ngritur. I bindur se ishte një këmbë ariu, pati kohë vetëm të thotë "ha tani ari, zemrën e bardhë të jevgut" para se të binte në tokë i vdekur nga frika...

Sigurisht të gjithë popujt, dhe veçanërisht në Ballkan, kanë anekdota të tilla për popujt përreth, të cilët i marrin me dëshirë për llogari të tyre. Ajo çka duhet, nuk është që të censurohet ky humor popullor, se ai i jep përtiditshmes një pikant që rromët dhe egjiptianet e shijojnë si në tavolinë ashtu edhe në jetë, por është e rëndësishme që përhapja e këtyre imazheve të shoqërohet me një vullnet pedagogjik që i vendos ato në kuadrin e tyre natyror: një bisedë e thjeshtuar e jetës fshatarake së kaluar, limitet e së cilës duhen njohur gjithmonë. Përkundrazi, këto imazhe mund të na sjellin një bazë të shkëlqyeshme për të luftuar, veçanërisht duke i përqeshur, të gjitha stereotipet që mbeten të lidhura me identitetin ballkano - egjiptian.

## Perbuzje dhe persekutim kundër evgjitëve dhe Ashkalive

Shqipëria e paraluftës nuk ishte aspak e dashur me të mjeruarit, mes të cilëve numëroheshin shumica e evgjitëve "të dukshëm", por nuk mund të flitet për persekutim në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Edhe në Jugosllavi, Ashkalitë nuk ishin trajtuar keq, vetëm të lënë në punën e tyre, si pjesa më e madhe e qytetarëve. Pas vdekjes së Titos, gjendja ndryshoi rrënjësisht, sepse Ashkalitë filluan pak nga pak të jenë shënjestra e serbëve racistë,

për faktin se ata shiheshin si "ciganë shqiptarë" - dy damka të rënda bashkë. Por me ndryshimin e situatës në 1999, disa ekstremistë shqiptarë kosovarë, partizanë të pastrimit etnik, filluan të ngacmojnë ashkalitë, në të njëjtën mënyrë si romët, për arsyen e thjeshtë se injorantët i ngatërrojnë me termin e përbashkët magjup, dhe ekstremistet luajnë rolin e injorantëve për të justifikuar abuzimet e tyre. Në këtë mënyrë në një popullate që ishte rreth 60 000 shpirta në fillim të vitit 1999 (sidomos në Pejë/ Peæ, Gjakovë/Đakovica, Prizren, Prishtinë dhe përreth, Ferizaj/Uroševac), vetëm 20 000 ishin në Dardani një vit më vonë, ndërkohë që vetëm 2 800 shtëpi nga 8 500 gjithsej i rezistuan shkatërrimit. Disa vrasje kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe, më e njohura mbetet ajo e Skenderajt ku u vranë në natën e 8 -9 Nëntorit 2000 katër Ashkali që UNHCR-i sapo i kishte bindur të kthehen në shtëpitë e tyre . Ky barbarizëm racist nuk ndaloi përgjatë gjithë vitit 2000, në përbuzjen absolute të kontributit të ashkalive në çeshtjen shqiptare. Shihet mire se pika e përbashkët midis romëve dhe ashkalive nuk është as kombëtare, as kulturore, por të jene viktimat të persekutimeve të tilla.

Ne fakt problemi qendror është i lidhur me përbuzjen dhe me mungesën e besimit që anëtarët e këtyre grupeve ndeshin çdo ditë. Është arsyeja për të cilën do të ishte utopike, madje hipokrite, t'i trajtosh brenda ditës si qytetarët e tjerë. Do të ishte sikur të mohonim në të njëjtën kohë këtë përbuzje të dhimbshme dhe identitetin e tyre historik, ndërkohë që është e rëndësishme që ballkano-egjyptianëve t'i njihet një status minoriteti historik dhe ngritja në vlerë e identitetit të tyre duke e bërë më të njohur, dhe veçanërisht me kërkime dhe me arsim, që të luftohet moskuptimi me të cilin ata ndeshen. Disa shoqata propozuan hyrjen e një lënde të Egjyptit të lashtë si lëndë fakultative për fëmijët e këtij grupi, çka që do të kishte një vlerë simbolike të rivlerësimit kulturor dhe të hapjes së shpirtit drejt horizonteve më klasike të qytetërimit të lashtë të Mesdheut. Në realitet, aplikimi i këtij propozimi ndeshet me pamjaftueshmërinë e kushteve të shkollimit nga e cila vuajnë shumë fëmijë ballkano-egjyptianë.

Ndryshimet e këtyre viteve të fundit kanë qenë një rast për Ashkalitë për t'u afirmuar, ose si të tillë për më të përmbajturit, ose si egjyptianë për më entuziastët, të dy termat duke shprehur përfundimisht dy pikpamje, njëra lokale dhe traditore, dhe tjetra intelektuale dhe e politizuar, të të njëjtit identitet. Janë konfliktet personale të mëpasshme midis grupeve ato që bënë që këto emërtime të përdoren si emërtime për grupe gjoja të ndryshëm. Duhet vënë re se Askalitë e Ferizajt/Uroševac kanë arritur më mirë afirmimin e tyre, me disa intelektualë të rinj të vendosur të mbrojnë njëherazi identitetin e tyre dhe njohjen e tyre si komb nga autoritetet shqiptare çka nuk kaloi pa sulme të shunshme të romëve proserbë jashtë vendit (serbi, Maqedoni, diaspora në Gjermani etj...). Megjithatë, ekuilibri etnik në Ballkan mund të arrihet vetëm falë zbatimit të së drejtës së tyre për t'u vetëidentifikuar lirisht dhe jo duke i përfshirë ata artificialisht në identitetin rom.

Edhe pse elementet e ndryshëm të paraqitur këtu nuk janë diçka e re apo e panjohur, afrimi dhe bashkëndimi i tyre përbën njëfarë risie që pa dyshim do të ndeshet për vite akoma me kokëfortësinë e atyre që e kanë të vështirë të ndryshojnë shikimin e vet mbi atë me të cilën janë mësuar, sidomos me vizionin e padallimtë të një bashkësie heteroklite "magjupësh" (ose gjetkë "ciganësh" etj.), kategori kjo përbuzëse që jo vetëm mbulon shumë grupe me identitete të ndryshme por e cila mohon identitetin e secilit prej këtyre grupeve. Zëvendësimi formal i etiketës "magjup" me etiketën "rom", për të gjitha këto grupe të marra si një i vetëm jo vetëm nuk e ndërron aspak vëzhgimin dhe trajtimin përbuzës si ndaj romëve dhe egjyptasve, por mund të çojë në konflikte midis popullsive të ndryshme brenda një kohe relativisht të shkurtër, dhe shenjat e para të këtyre konflikteve po shfaqen tashmë. Paradoksalisht, kjo analizë do të ndeshet edhe me kundërshtimet e disa mbrojtësve të identitetit rom, të cilët janë të bindur që të dallosh midis popujve që s'kanë gjë të përbashkët veç një etikete profane të vendosur në Mesjetë nga fshatarët bizantinë do të thotë, siç pretendojnë ata, "të përçash për të sunduar". Atyre do t'u duhet ende kohë për të kuptuar se përkundrazi, përfshirja artificiale e balkano-egjyptasve në të njëjtin grup me romët do t'u priste rrugën të dy grupeve për të afirmuar dhe zhvilluar identitetin e tyre dhe do të ishte zbatim i një formule ende më të rrezikshme: "ngatërro për të sunduar". Në të vërtetë, të dallosh atë çka është e ndryshme nga pikëpamja historike dhe shkencore nuk është aspak përçarje; përkundrazi, është një metodë e efektshme për të krijuar një kontekst më të shëndoshë i cili do të përbente një bazë më të fortë për solidaritetin midis shumë grupeve që janë tradicionalisht viktimat të racizmit dhe është e qartë që kjo plagë nuk prek vetëm romët dhe ballkano-egjyptasët.



**Iniciative e Re Demokratike e  
Kosovës  
IRDK**

**Zgjedhjet Lokale  
03 Nëntor, 2013**